



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

RREGULLORE
PËR PROCEDURAT DHE RREGULLAT E MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE TË
BORDIT TË MBIKËQYRJES PUBLIKE

Miraturar me Vendimin nr. 39, datë 28.08.2025 të Bordit të Mbikëqyrjes Publike

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

1. Kjo rregullore ka për qëllim zbatimin e kërkesave ligjore për financimin e veprimtarisë dhe përcaktimin e rregullave për mbledhjen e të ardhurave të Bordit të Mbikëqyrjes Publike.

Neni 2
Baza Ligjore

Kjo rregullore hartohet në zbatim të nenit 4/1 dhe nenit 5 të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Neni 3
Fusha e zbatimit

Kjo rregullore zbatohet për audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, organizata profesionale e audituesve ligjorë, organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar dhe subjekteve të tjera sipas ligjit për auditimin.

Neni 4
Shkurtime dhe Përkufizime

1. Shkurtime dhe përkufizimet e përdorura në këtë rregullore kanë këto kuptime:

NjEIP – Njësi ekonomike me interes publik

BMP - Bordi i Mbikëqyrjes Publike

SM – Struktura Mbështetëse e Bordit të Mbikëqyrjes Publike

KPAP - Komisioni i Provimeve të Aftësive Profesionale

AL - Auditues Ligjor

SHA - Shoqëri Audituese



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

OPAL – Organizata Profesionale e Audituesve Ligjorë

OPKM – Organizata/t Profesionale e Kontabilistëve të Miratuar

KM – Kontabilist i Miratuar

Të ardhura - i referohet burimeve të financimit për ushtrimin e veprimtarisë mbikëqyrëse të BMP në përputhje me kërkesat ligjore për ligjin mbi auditimin.

Ligji për auditimin - ligji nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Periudhë/a e raportimi/t – Në këtë rregullore me periudhë raportimi do të nënkuptohet periudha gjatë të cilës është lëshuar raporti i auditimit. Periudha e raportimit fillon në datën 1 janar dhe përfundon në datën 31 dhjetor.

2. Të gjitha termat e përdorura në këtë rregullore janë të njëjta me ato të përdorura në nenin 2 të ligjit për auditimin.

Neni 5

Financimi i Bordit të Mbikëqyrjes Publike

1. Bordi i Mbikëqyrjes Publike për ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave administrative dhe të mbikëqyrjes publike mbledh të ardhurat nga:
 - a) pagesa prej 3 për qind, e caktuar mbi shumën e honorarit të faturuar për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik, të paguara nga shoqëritë audituese/audituesit ligjorë, që kryejnë auditime të njësive ekonomike me interes publik;
 - b) Fonde të tjera në masën jo më shumë se 10% si kontribut i organizatave profesionale subjekt i mbikëqyrjes nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
 - c) shumat që u ngarkohen audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese, subjekt të masave disiplinore, për të mbuluar shpenzimet e procedurave disiplinore, të cilat vendosen nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike;
 - ç) teprica të papërdorura nga proceset e provimit përfundimtar të kandidatëve për kontabilistë të miratuar dhe auditues ligjorë;
 - d) fonde të tjera, nga burime të ligjshme, të pandikuara nga audituesit ligjorë, përfshirë, por pa u kufizuar në to, grantet e akorduara në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit;
 - dh) Shuma prej 20% e të ardhurave të arkëtuara nga gjobat e vendosura nga organizatat profesionale derdhet në buxhetin e Bordit të Mbikëqyrjes Publike;
 - e) Nëpërmjet Buxhetit të Shtetit, sipas përcaktimeve në ligjin vjetor të buxhetit.
2. Të ardhurat e siguruara, nga gjerat (a) deri (d) të pikës 1, të këtij neni, përdoren nga bordi për financimin e veprimtarisë së tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Teprica e të ardhurave, në fund të vitit buxhetor aktual, kalon në reduktim të masës së financimit nga Buxheti i Shtetit për vitin pasardhës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

KREU II
PROCEDURAT DHE RREGULLAT E MBLEDHJES SË TË ARDHURAVE

Neni 6
Deklarimi i angazhimeve

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të regjistruara në regjistrin publik ose që kanë qenë të regjistruara në regjistrin publik përgjatë periudhës së raportimit, duhet të dorëzojnë pranë BMP brenda datës 30 Janar të çdo viti pasardhës, informacionin në lidhje me shërbimet e kryera në periudhën e raportimit, si më poshtë:
 - a) të gjitha angazhimet e auditimit ligjor;
 - b) të gjitha angazhimet e tjera të dhënies së sigurisë, shërbimet e kontabilitetit shërbimet e rishikimit dhe shërbimet e tjera profesionale;
 - c) honorarët e faturuar për shërbimet e përcaktuara në germën (a) dhe (b) më sipër.
2. Formati i unifikuar i Raportimit të Angazhimeve përcaktohet në Rregulloren për kontrollin e cilësisë.

Neni 7
Mbledhja e të ardhurave nga pagesa prej 3%

1. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese të cilët angazhohen në auditimin e njësive ekonomike me interes publik detyrohen të paguajnë 3 (tre) për qind mbi shumën e honorarit të faturuar për çdo auditim të njësive ekonomike me interes publik.
2. Audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese do të llogarisin detyrimin në lekë për t'u paguar duke shumëzuar vlerën në lekë të faturës së vetme ose vlerën në lekë të secilës fature të lëshuar të honorarit të auditimit të NjEIP me 3 (tre) për qind.
3. Ky detyrim paguhet jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga data e raportit të auditimit, me përshkrimin: "Emri i Audituesit Ligjor ose Shoqërisë Audituese_NUIS_Pagesë tre për qind për NjEIP_Periudha e Raportimit".

Neni 8
Verifikimi i deklarimit të angazhimeve të auditimit ligjor të NjEIP

1. Struktura Mbështetëse e BMP verifikon nëse angazhimet e auditimit janë klasifikuar në përputhje me kërkesat e nenit 2, pika 23 të ligjit për auditimin dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave për përcaktimin e shoqërive të tjera shtetërore ose private, të rëndësishme për interesin e publikut, për shkak të natyrës së biznesit, madhësisë ose numrit të punëmarrësve të tyre për çdo Raportim të Angazhimeve, brenda 15 ditëve pune nga data e deklarimit nga audituesi ligjor ose shoqëria audituese.
2. Në rast se në informacionin e deklaruar konstatohen pasaktësi në klasifikimin e deklaruar të angazhimit të auditimit, struktura mbështetëse kryen klasifikimin e duhur të angazhimit të auditimit si NjEIP dhe përlogarit vlerën e detyrimit të pagesës 3(tre) për qind.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

3. Për qëllime të rakordimit të detyrimeve dhe likuidimeve të kryera, brenda datës 20 Mars të vitit pasardhës të periudhës së raportimit, struktura mbështetëse i njofton audituesit ligjor ose shoqërisë audituese, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, aktin e rakordimit që përmban situatën e përmbledhur të detyrimeve dhe likuidimeve. Sipas rastit, akti i rakordimit do të përmbajë edhe kamatëvonesat e llogaritura në përputhje me pikën 1 të nenit 16 të kësaj rregullore.
4. Vlerat mbi 1 000 (njëmijë lekë) e paguara më tepër, do të njihen si teprice kreditore për periudhën e raportimit pasardhës.
5. Në rast se në aktin e rakordimit rezulton se audituesi ligjor ose shoqëria audituese ka detyrime të papaguara, këto detyrime duhet të paguhen brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës të periudhës së raportimit, me përshkrimin: "Numri i aktit të rakordimit_Emri i Audituesit Ligjor ose Shoqërisë Audituese_NUIS_Pagesë tre përqind për NjeIP_Periudha e Raportimit". Vlerat nën 1 000 (njëmijë lekë) nuk do të llogariten si detyrim për të paguar.

Neni 9

Mbledhja e kontributit të organizatës profesionale të audituesve ligjorë

1. Detyrimi për kontributin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë do të jetë deri në 10 (dhjetë) për qind e totalit të të ardhurave që organizata ka realizuar për vitin ushtrimor paraardhës. Brenda muajit Tetor, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, pasi merr mendimin e organizatës profesionale të audituesve ligjorë, përcakton përqindjen e masës së kontributit që do të zbatohet për vitin pasardhës.
2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë duhet të dorëzojë pranë BMP, brenda datës 20 Maj të çdo viti, pasqyrat financiare të vitit ushtrimor paraardhës.
3. Afati i kryerjes së pagesës do të jetë brenda datës 20 Maj të çdo viti.

Neni 10

Mbledhja e kontributit të organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar

1. Detyrimi për kontributin e organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, të njohura nga BMP, do të jetë deri në 10 (dhjetë) për qind e totalit të të ardhurave që organizata ka realizuar për vitin ushtrimor paraardhës. Brenda muajit Tetor, Bordi i Mbikëqyrjes Publike, pasi merr mendimin e organizatave profesionale të kontabilistëve të miratuar, përcakton përqindjen e masës së kontributit që do të zbatohet për vitin pasardhës.
2. Organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar duhet të dorëzojnë pranë BMP, brenda datës 20 Maj të çdo viti, pasqyrat financiare të vitit ushtrimor paraardhës.
3. Afati i kryerjes së pagesës do të jetë brenda datës 20 Maj të çdo viti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

Neni 11

Mbledhja të ardhurave nga arkëtimi i gjobave të vendosura nga organizatat profesionale

1. Organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar raportojnë brenda datës 20 Janar të çdo viti lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura ndaj anëtarëve të tyre.
2. Organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe organizatat profesionale të kontabilistëve të miratuar kanë detyrimin të paguajnë pranë BMP, 20% të vlerës së arkëtuar nga gjobat që organizata profesionale e audituesve ligjorë dhe organizatat e kontabilistëve të miratuar kanë vendosur ndaj anëtarëve të tyre.
3. Afati i kryerjes së pagesës do të jetë brenda datës 31 Janar të çdo viti.

Neni 12

Mbledhja e të ardhurave nga procesi i provimeve të aftësive profesionale

1. Tarifat e regjistrimit dhe pjesëmarrjes në provimet e aftësimit profesional miratohen me vendim të BMP, bazuar në një analizë ekonomike, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të organizimit, mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë së procesit.
2. Pagesa e tarifave të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, kryhet nga kandidatët për regjistrimin dhe pjesëmarrjen në testimet në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, në llogarinë rrjedhëse të BMP.
3. Shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kanë fituar titullin “Auditues ligjor” apo ekuivalentin e tij, si edhe ata që janë miratuar për dhënien e sigurisë të raportimit të qëndrueshmërisë dhe janë të regjistruar për të ushtruar veprimtarinë si anëtarë të një organizate profesionale të audituesve ligjorë në një shtet tjetër, të cilët do të kryejnë vetëm testimet në kuadrin e provimit përfundimtar të aftësive profesionale, në disiplinat e legjislacionit fiskal, të shoqërive tregtare, të sigurimeve shoqërore, të drejtën e punës dhe të drejtën civile, në masën që këto i interesojnë auditimit ligjor, kuadrin ligjor dhe rregullator në masën që i takojnë dhënies së sigurisë për raportimin e qëndrueshmërisë, paguajnë tarifat për njohjen e provimeve të kryera, sipas tarifave të përcaktuara nga BMP.
4. Tepçicat e përdorura nga proceset e provimit përfundimtar të kandidatëve për kontabilistë të miratuar dhe auditues ligjorë, do të alokohen për financimin e veprimtarisë së BMP.
5. BMP miraton për çdo sezon, buxhetin lidhur me realizimin e procesit të testeve, në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale sipas propozimit të strukturës mbështetëse.

Neni 13

Mbledhja e pagesave për masat disiplinore “dënim me gjobë”

1. Audituesit ligjorë ose shoqëritë audituese të cilëve u është vendosur masë disiplinore “dënim me gjobë” me vendim të BMP, janë të detyruar të shlyejnë brenda 2 muajve, masën e gjobës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

2. Në rast se masa e gjobës nuk shlyhet brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, zbatohet masa disiplinore e pezullimit të përkohshëm të ushtrimit të aktivitetit të auditimit ligjor, deri në momentin e shlyerjes së plotë të gjobës.

Neni 14

Mbledhja e të ardhurave nga fonde të tjera

1. BMP mund të mbledhë të ardhura në kuadër të sigurimit të cilësisë dhe mbikëqyrjes së profesionit në formën e granteve të akorduara.
2. Mënyra e përdorimit të këtyre granteve përcaktohet me vendim të BMP.
3. BMP mund të mbledhë të ardhura nga organizimi i trajnimeve, i seminareve, nga publikime në funksion të mbikëqyrjes dhe sigurimit të cilësisë së profesionit.
4. Në kuadër të mbikëqyrjes së kualifikimit të vijueshëm profesional:
 - a. institucionet e arsimit të lartë që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional për audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar do të paguajnë një kontribut prej 10% e të ardhurave vjetore të realizuar nga kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional;
 - b. qendrat e tjera të kualifikimit profesional, të cilat kanë mjediset dhe personelin e duhur për garantimin e një kualifikimi cilësor, në përputhje me programet e miratuara për kualifikimin e vazhdueshëm profesional që dëshirojnë të organizojnë kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional për audituesit ligjorë dhe kontabilistët e miratuar do të paguajnë një kontribut prej 10% e të ardhurave vjetore të realizuar nga kurset e kualifikimit të vijueshëm profesional;
 - c. shoqëritë audituese, të cilat kanë kapacitete për të organizuar kualifikimin për të punësuarit e vet, do të paguajnë një tarifë fikse vjetore prej 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë.
5. Bordi mund të sigurojë të ardhura nga interesat e depozitës bankare.
6. Bordi arkëton të ardhura të tjera nga burime të ligjshme në kuadër të mbikëqyrjes së profesionit dhe sigurimit të cilësisë.

Neni 15

Mos shlyerja e detyrimeve

1. Kur audituesi ligjor ose shoqëria audituese nuk shlyen detyrimin edhe pas përfundimit të afatit për llogaritjen e kamatëvonesës, zbatohen rregullat e parashikuara në rregulloren e funksionimit të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese.
2. Kur audituesi ligjor ose shoqëria audituese nuk shlyen brenda afatit të përcaktuar në pikën 5 të nenit 8, zbatohen rregullat e parashikuara në rregulloren e funksionimit të Komitetit të Regjistrimit të audituesve ligjorë dhe shoqërive audituese.



BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

3. Kur organizata profesionale e kontabilistëve të miratuar nuk shlyen detyrimin brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 10, zbatohen rregullat e parashikuara për rregullimin dhe mbikëqyrjen e funksionimit të organizatave profesionale dhe profesionit të kontabilistit të miratuar.

Neni 16

Llogaritja e kamatëvonesave

1. Mos shlyerja e detyrimit brenda afatit të parashikuar në pikën 3 të nenit 7 bëhet shkak për llogaritjen e kamatëvonesave. Kamatëvonesa llogaritet në masën 120 për qind e shkallës së interesit ndër bankar të Bankës së Shqipërisë e cila shpallet nga kjo e fundit për çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të një tremujori më parë. Në çdo rast kamatëvonesat do të llogariten nga data e lindjes së detyrimit për të paguar deri në datën e kryerjes së pagesës, por jo më shumë se 12 muaj.
2. Mos shlyerja e detyrimit brenda afatit të parashikuar në pikën 3 nenit 9 bëhet shkak për llogaritjen e kamatëvonesave. Kamatëvonesa llogaritet në masën 120 për qind e shkallës së interesit ndër bankar të Bankës së Shqipërisë e cila shpallet nga kjo e fundit për çdo tremujor, në bazë të shkallës mesatare të një tremujori më parë. Kamatëvonesat do të llogariten nga data e lindjes së detyrimit deri në datën e kryerjes së pagesës, por jo më shumë se 12 muaj.

Neni 17

Llogaritë Bankare të BMP

1. Të ardhurat e përcaktuara në nenin 5 të kësaj rregulloreje do të arkëtohen për llogari të BMP në llogarinë rrjedhëse pranë një banke të nivelit të dytë.
2. Të gjitha pagesat në funksion të veprimtarisë së BMP do të realizohen nëpërmjet sistemit bankar në përputhje me manualin e menaxhimit dhe kontrollit financiar.
3. Për llogari dhe në emër të BMP hapen të paktën 2 (dy) llogari rrjedhëse në monedhën Lekë dhe Euro në dy prej bankave të nivelit të dytë, me cilësinë e personit juridik publik.
4. Me vendim të BMP mund të hapet një llogari depozite në një nga bankat e nivelit të dytë, me qëllim gjenerimin e të ardhurave nga interesat.

Neni 18

Dispozita kalimtare dhe përfundimtare

1. Struktura mbështetëse do njoftojë audituesit ligjorë dhe shoqëritë audituese, nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit, aktin e rakordimit për periudhën e mëparshme të raportimit brenda datës 15 Tetor 2025.
2. Afati i parashikuar në pikën 3 të nenit 7 të kësaj rregulloreje do të zbatohen për angazhimet e auditimit të realizuara gjatë vitit 2025, ose periudha e raportimit 2025.
3. Afatet e parashikuara në pikën 1 të nenit 6, pikat 1, 3, 5 të nenit 8, pikat 2 dhe 3 të nenit



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BORDI I MBIKËQYRJES PUBLIKE

9, pikat 2 dhe 3 të nenit 10, pikat 1 dhe 3 të nenit 11 hyjnë në fuqi nga data 01.01.2026.

4. Afatet e parashikuara në pikën 1 të nenit 9 dhe pikën 1 të nenit 10 zbatohen duke filluar nga Tetor 2025.
5. BMP do të miratojë buxhetin për sezonin e vitit 2025, lidhur me realizimin e procesit të testimeve në kuadër të provimit përfundimtar të aftësive profesionale, sipas propozimit të strukturës mbështetëse, bazuar në preventivin e shpenzimeve për organizimin dhe realizimin e këtij procesi të paraqitur nga sekretaria teknike e KPAP.
6. Ngarkohen për zbatimin e kësaj rregulloreje Bordi Mbikëqyrjes Publike, Struktura Mbështetëse, komisionet dhe grupet e punës të ngritura pranë BMP, organizatat profesionale që janë subjekt i mbikëqyrjes së BMP, audituesit ligjorë dhe shoqëritë e auditimit.
7. Në rast mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera nënligjore të nxjerra nga Bordi i Mbikëqyrjes Publike, do të zbatohen dispozitat e kësaj rregulloreje.